



Jeni arrestuar sipas një urdhri arresti të Evropës dhe jeni çuar në stacionin e policisë ose në një vendndodhje tjetër për t'u marrë në pyetje. Çfarë të drejtash ju takojnë?

Albanees

Një nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ka lëshuar një urdhër arresti të Evropës ndaj jush, ose sepse dyshoheni që keni kryer një krim, ose sepse jeni dënuar tashmë nga një gjykatë në këtë shtet anëtar. Ky shtet ka kërkuar që Holanda t'ju dorëzojë dhe si rrjedhojë, jeni arrestuar nga policia, Royal Netherlands Merchaussee ose një shërbim tjetër hetimi holandez. Është e rëndësishme që t'i kuptoni qartë të drejtat tuaja. Si rrjedhojë, ju lutemi ta lexoni me kujdes këtë fletë informacioni.

Çfarë do të ndodhë tani?

Jeni arrestuar dhe jeni çuar në një stacion policie, Prokurori ose ndihmëprokurori do të vendosë tani nëse duhet të qëndroni në stacionin e policisë. Ju do të qëndroni në stacionin e policisë për maksimumi tre ditë. Në disa raste, prokurori mund të vendosë që do të qëndroni në stacionin e policisë edhe për tre ditë të tjera. Ne e quajmë këtë "ndalim për ekstradim".

- Brenda tre dhe deri në gjashtë ditë, ju do t'ju lexohet aktpadia përpara gjykatësit ekzaminues të gjykatës në Amsterdam. Gjykatësi ekzaminues do të vendosë nëse do të qëndroni i ndaluar. Nëse po, ju do të transferoheni në një qendër ndalimi.
- Brenda gjashtë ditëve dhe maksimumi nëntëdhjetë ditëve, do të caktohet një seancë publike dëgjimi në gjykatën e Amsterdimit. Në atë seancë dëgjimi, do të vlerësohet kërkesa për dorëzim nga shteti anëtar i BE-së që e ka lëshuar. Ju keni të drejtë që të merrni pjesë në seancën publike të dëgjimit (me avokatin tuaj) dhe do të dëgjoheni nga gjykata në Amsterdam, por mund të zgjidhni edhe mos të merrni pjesë.

- Nuk do të merrni pjesë? Atëherë avokati juaj mund t'ju prezantojë dhe të flasë në emrin tuaj. Megjithatë, nëse "kërkesa për ekstradim" është pezulluar, juve **ju kërkohet** që të vini në gjykatë.
- Gjykata në Amsterdam do të vendosë jo më vonë se dy javë pas seancës së dëgjimit, nëse do ta pranojë kërkesën për dorëzim. Nëse ajo e pranon dorëzimin, ju, në parim, do t'i dorëzoheni shtetit anëtar të BE-së që ka lëshuar urdhrin, brenda 10 ditësh.

Procedura e shpejtuar

Ju mund të zgjidhni gjithashtu që të bini dakord me kërkesën për dorëzim nga shteti anëtar i BE-së që ka lëshuar urdhrin. Ju nuk do të kaloni nëpër seancën publike të dëgjimit në gjykatën e Amsterdimit. Nëse bini dakord që të dorëzoheni, procedura do të jetë më e shpejtë.

Atëherë, ju duhet të deklaroni përpara një gjykatësi në një kohë të shkurtër që pranoni që të dorëzoheni. Mund të marrë pjesë edhe avokati juaj. Kjo quhet "procedurë e përshpejtuar". Nëse gjykata e pranon dorëzimin, ju do të transferoheni në shtetin anëtar të BE-së që ka lëshuar urdhrin, brenda 10 ditësh.

Pranimi i dorëzimit ka një pasojë:

- Pasi të keni deklaruar përpara gjykatësit që e pranoni dorëzimin, nuk mund ta ktheni më;

Është e rëndësishme që të këshilloheni me kujdes me avokatin tuaj, përpara se të zgjidhni që të pranoni dorëzimin.

Cilat janë të drejtat tuaja?

- Nuk jeni të detyruar t'u përgjigjeni pyetjeve (keni të drejtën të mos flisni);
- Keni të drejtën e përfaqësimit ligjor nga një avokat;
- Keni të drejtën e ndihmës nga një përkthyes;
- Keni të drejtën e kujdesit mjekësor.

E drejta për të mos folur

Nuk ju kërkohet që të bëni asnjë deklaratë në asnjë moment të këtij procesi. Nuk jeni të detyruar t'u përgjigjeni pyetjeve nga hetuesit, (ndihmës) prokurori publik ose gjykatësi i ekzaminimit.

E drejta për një avokat

Keni të drejtën e përfaqësimit ligjor nga një avokat. Policia do të sigurohet që të kontaktoheni nga një avokat, sa më shpejt që të mundet pas arrestimit. Nëse njihni një avokat me të cilin do të donit të këshilloheshit, edhe kjo është e mundshme. Tregojini policisë sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse preferoni një avokat të caktuar.

Mund të flisni gjithmonë në fshehtësi me avokatin tuaj. Avokati juaj nuk duhet të flasë me persona të tjerë rreth çështjes suaj, pa lejen tuaj. Ju mund të këshilloheni me avokatin tuaj deri gjysmë ore përpara marrjes në pyetje nga (ndihmës) prokurori publik.

Avokati juaj mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Përpara se avokati juaj të mbërrijë te stacioni i policisë, mund të kalojë pak kohë. Ai duhet të arrijë te stacioni i policisë brenda dy orësh, por kjo nuk është gjithnjë e mundshme. Marrja në pyetje mund të fillojë vetëm nëse avokati është i pranishëm, përveçse kur tregoni shprehimisht që hiqni dorë nga e drejta e ndihmës ligjore gjatë kësaj marrjeje në pyetje. Pas marrjes në pyetje, (ndihmës) prokurori publik do të vendosë nëse duhet të qëndroni më gjatë në stacionin e policisë.

Nëse policia ju gjen një avokat, ju nuk ju duhet që të paguani për shërbimin. Por nëse zgjidhni avokatin tuaj, duhet t'i paguani vetë tarifat në rrethana të caktuara. Të dhënat tuaja personale do t'i transmetohen Këshillit të ndihmës ligjore dhe do të përpunohen në regjistrat e tyre.

Ju mund t'i kërkonti gjithashtu prokurorit që t'ju ndihmojë një avokat në shtetin anëtar të BE-së që ka lëshuar urdhrin e arrestit të Evropës ndaj jush. Ai avokat mund ta njoftojë avokatin tuaj holandez rreth procesit në shtetin anëtar të BE-së që ka lëshuar urdhrin e arrestit të Evropës ndaj jush.

Autoritetet e shtetit anëtar të BE-së që ka lëshuar urdhrin e arrestit të Evropës ndaj jush mund t'ju njoftojnë rreth mundësisë së përdorimit të një avokati aty. Ju duhet ta organizoni këtë vetë, por avokati juaj holandez mund t'ju ndihmojë.

Çfarë bën avokati?

Avokati juaj do të përfaqësojë interesat tuaja dhe do t'ju ndihmojë përgjatë procedurës së dorëzimit: gjatë marrjes në pyetje nga policia, leximit të aktpadisë përpara gjykatësit të ekzaminimit dhe në seancën e dëgjimit publik në gjykatën e Amsterdimit.

Avokati:

- ju shpjegon se si funksionon kjo procedurë;
- ju shpjegon të drejtat dhe detyrimet tuaja;
- ju jep këshillë ligjore;
- njofton familjen, miqtë ose punëdhënësin tuaj për situatën tuaj (nëse dëshironi);
- kontakton avokatin tuaj në shtetin që ka kërkuar dorëzimin;
- mund të flasë në gjykatë në emrin tuaj.

E drejta për një përkthyes

Keni të drejtën e ndihmës nga një përkthyes nëse nuk e flisni ose kuptoni (mirë) gjuhën holandeze. Edhe nëse e flisni dhe/ose kuptoni pak gjuhën holandeze, ju keni të drejtën e ndihmës nga një përkthyes. Tregojini policisë që nuk e kuptoni ose nuk e kuptoni mirë dhe do t'ju caktohet një përkthyes. Përkthyesi do të ofrojë ndihmë gjithashtu gjatë diskutimeve me avokatin. Përkthyesi nuk duhet të flasë rreth çështjes suaj, pa lejen tuaj. Nuk ju duhet që të paguani për përkthyesin.

E drejta për kujdes mjekësor

Keni të drejtën e kujdesit mjekësor. Tregojini policisë nëse ndiheni i sëmurë, dëshironi që t'ju vizitojë një mjek ose keni nevojë për kujdes mjekësor. Gjithashtu, tregojini policisë nëse merreni (dhe keni nevojë për) ilaçe.

Të drejta të tjera

Keni të drejtën për të pasur një kopje të urdhrin të arrestit të Evropës. Nëse ky urdher është hartuar në një gjuhë që nuk e kuptoni, ju keni të drejtën e përkthimit të pjesëve të tij kryesore.

Nëse nuk keni kombësi holandeze, mund t'i kërkonti hetuesit që të njoftojë konsulatën ose ambasadën në shtetin e origjinës, që ju kanë ndaluar.

Keni pyetje?

Keni ende pyetje? Nëse po, drejtojani këto avokatit holandez ose hetuesit.

Kolofon

Kjo fletë informacioni është botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Rajoneve të Sigurisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë

PO Box 20301 | 2500 EH The Hague

Tetor 2024 | 24407239

Ju nuk ju takon asnjë e drejtë nga përmbajtja në këtë fletë informacioni.

24407239 Informatieblad

Jeni arrestuar sipas një urdhri arresti të Evropës dhe jeni çuar në stacionin e policisë ose në një vendndodhje tjetër për t'u marrë në pyetje. Çfarë të drejtash ju takojnë? (Albanees)

